



# PLANI STRATEGJIK I INSPEKTIMIT

2024 - 2026

PËR SIPËRMARRËSIT E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

DATA E PUBLIKIMIT: MARS 2024

## HYRJE

Tashmë më shumë se kurrë çdo qytetari i nevojitet lidhja me internetin me qëllim përmbushjen e nevojave për punë, mësim si dhe kujdes shëndetësor. Aksesit në informacionin është i rëndësishëm për të marrë vendime të drejta për jetët tona.

Asgjë nuk kemi kaluar më parë se sfidat që u përballëm gjatë periudhës së pandemisë. Ajo kohë ka zbuluar të vërtetën të vështira pasojat e të cilave mund të vinin edhe nga aksesit i kufizuar në internet. Të gjithë atyre që u mohua qasja në internet ju kufizuan mundësitë në arsim, punë dhe kujdes shëndetësor. Kjo tregon se teknologjitë e komunikimit sot kanë një rëndësi të veçantë dhe që mund të karakterizohet si infrastrukturë e mundësive.

Gjithashtu, siguria publike është parësore dhe për këtë duhet të jemi të përkushtuar duke bërë sa më shumë në këtë drejtim me qëllim që rrjetet tona të komunikimit janë të sigurta, te pastra dhe efikase.

Duhet ta përdorim këtë moment për të ndërtuar një themel për rritje të re dhe mundësi të reja në botën post - pandemike.

Inspektimi është një hallkë e rëndësishme e shtetit ligjor për përmirësimin e klimës së biznesit dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në zbatimin e rregullave dhe standardeve të ligjore të vendosura. Inspektimi në vetvete ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë. Ky qëllim i veprimtarisë së inspektimit arrihet nëpërmjet vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit si dhe dokumentimit të praktikave të mira.

Sa më sipër, dokumenti “Plani Strategjik i Inspektimit” i detajuar paraqitet i nevojshëm për të përcaktuar qëllimin, misionin dhe objektivat e strukturave përgjegjëse në DMKI për ushtrimin e veprimtarisë inspektuese të AKEP.

## ➤ MISIONI I DREJTORISË TË MONITORIMIT, KONTROLLIT DHE INSPEKTIMEVE (DMKI)

Misioni i DMKI, siguron zbatimin e standardeve të organizatave ndërkombëtare ku aderon Republika e Shqipërisë si ITU, ECC, UPU, BEREK, ERGP etj, në ushtrimin e kompetencave ligjore të AKEP lidhur me monitorimin e përdorimit të spektrit të frekuencave, në përputhje me Planin Kombëtar të Frekuencave dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave, monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, veprimtaritë e ofruesve të shërbimeve postare, si dhe zbatimin e procedurave të inspektimit, në përputhje me ligjin nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “*Për komunikimet elektronike dhe postare*” të ndryshuar, ligjin nr. 46/2015 “*Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë*” si dhe akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në zbatim të tyre.

Për të garantuar ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*” dhe aktet e tjera në zbatim të këtij ligji, veçanërisht të zbatimit të kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm si dhe të përdorimit të frekuencave dhe numeracionit në përputhje me kushtet e përcaktuara në Autorizimet Individuale, AKEP-i kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve dhe monitorimin e përdorimit të spektrit prej tyre.

Misioni kryesor i DMKI është përmirësimi i efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarisë inspektuese në AKEP nëpërmjet:

- Zbatimit efektiv dhe eficient të legjislacionit në fuqi;
- Përcaktimi i procedurave të inspektimeve që kryen AKEP në zbatim të detyrimeve dhe ushtrimit të kompetencave ligjore, gjatë kontrollit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (sipërmarrësve) si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike (subjekti) sipas ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar , akteve nënligjore, si dhe akteve administrative të nxjerra nga AKEP, në zbatim të këtij ligji;
- Përcaktimi i rregullave për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative nëpërmjet inspektimit, monitorimit të spektrit të frekuencave dhe veprimit “*kryesisht*” të AKEP, përcaktimi i procedurave dhe i afateve të ankimit ndaj akteve të monitorimi- inspektimit të AKEP që vendosin masa administrative, si dhe i procedurave të ekzekutimit të sanksioneve administrative.

Qëllimi i këtij misioni është kryerja e inspektimit të veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike ose çdo personi tjetër fizik apo juridik që zhvillon veprimtari në fushën e komunikimeve elektronike dhe vendosja e sanksioneve në rastet e vërtetimit të kundërvajtjeve administrative, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe nënligjore, kompetencat e AKEP dhe parimet e së drejtës.

## ➤ KUADRI LIGJOR

- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar, *“Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 *“Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”*;
- Ligji Nr. 44/2015 datë 30.04.2015 *“Kodi i Procedurave Administrative”*;
- Rregullore Nr. 46, datë 27.10.2016 *“Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”*;
- Rregullore Nr. 2 datë 21.02.2008 *“Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL”, dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”*;
- Rregullore për Autorizimin Individual miratuar me VKD Nr. 510 datë 04.11.2008, shfuqizuar sipas nenit 13 të rregullores Nr. 30 datë 05.12.2013, miratuar me VKD Nr.2395, datë 05.12.2013;
- Rregullore e Autorizimit të Përgjithshëm Nr. 47, datë 26.10.2017;
- Rregullore e Brendshme të AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 datë 24.04.2004, e ndryshuar;
- Rregullore Nr. 16, datë 16.04.20210 *“Për Treguesit e cilësisë së shërbimit”*;
- Rregullore Nr. 43, datë 22.09.2016 *“Për mënyrën e zbatimit të “Portabilitetit të Numrit”*;
- Rregullore Nr. 22 datë 24.06.2011 *“Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe fibrave optike ndër urbanë të komunikimeve elektronike”*;
- Rregullore Nr. 27 datë 21/09/2012 *“Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtete aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”*;
- Rregulloren Nr. 49, datë 11.03.2021, *“Për mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të komunikimeve elektronike publike”*,

- Rregullore Nr. 37 datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”;
- Ligje dhe akte të tjera normative si rregullore, urdhra, marrëveshje apo memorandume në fuqi të AKEP.

## ➤ OBJEKTIVAT E SEKTORIT TË KONTROLLIT DHE INSPEKTIMIT PËR VITET 2024 – 2026

Mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi i veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike si më poshtë vijon:

- Inspektime të programuara të Sipërmarrësve të Komunikimeve Elektronike dhe Regjistrarëve të Domain-eve në përputhje me Planin Strategjik dhe Vjetor sipas përcaktimeve të Rregullores Nr. 46, datë 27.10.2016 “Metodikë e Inspektimit të Veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” dhe Rregullores Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për Regjistrimin dhe Administrimin e Emrave të Domain-eve nën “.AL”, dhe nën domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, org.al dhe .net.al”;
- Ushtrimi i kontrollit në distancë i veprimtarisë së subjekteve ofrues të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike për çështjet e përshkruara në pikën 3.1.4 të Rregullores Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodikë Inspektimit të Veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” si dhe Urdhrit nr. 343, datë 7.06.2018 “Për procedurën e për inspektimit në distance, administrimin e informacionit të përftuar dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit” si prioritet i sektorit të kontrollit dhe inspektimit, e cila në bashkëpunon me sektorët e tjerë të AKEP kryen verifikime sistematike mbi detyrimet e ofruesve zbatimin e kuadrit rregullator (*Rezultatet e inspektimit në distancë janë pjesë e informacionit për Tabelën e Vlerësimit të Riskut*);
- Inspektime rastësore në bazë të ankesave të iniciuar nga autoritetet shtetërore, sipërmarrësit, personat fizikë apo juridikë, si dhe në raste kur ka indice dhe dyshimi për shkelje të akteve ligjore në fuqi. Në këtë aspekt do të menaxhohet informacioni i përftuara kryesisht edhe nga shkëmbimi i informacionit institucional me DPT, DPP, QKB dhe agjenci të tjera shtetërore, por jo vetëm, në kuadër të luftës kundër informalitetit;

- Bashkëpunimi i (DMKI) me Drejtoritë e tjera të AKEP-it për problemet e konstatuara si dhe realizimin e detyrave të përbashkëta, të cilat lidhen vetëm me funksionet inspektuese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;
- Nxitjen e konkurrencës së lirë dhe efektive ndërmjet ofruesve të shërbimeve komunikimeve elektronike, duke asistuar kur kërkohet nga DTMR dhe kryer inspektime të përbashkëta me ekspertët e saj për të garantuar dhe siguruar shërbim transparent, mos diskriminues dhe të ndershëm;
- Bashkëpunimi i (DMKI) me Drejtoritë e tjera të AKEP-it për problemet e konstatuara si dhe realizimin e detyrave të përbashkëta, të cilat lidhen vetëm me funksionet inspektuese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;
- Me qëllim të përmirësimit e metodave inspektuese, ky Plan Strategjik i Inspektimit përcakton se planifikimi i inspektimit duhet të përgatitet mbi bazë risku që nënkupton se inspektimi fokusohet në ato subjekte (sipërmarrës) veprimtaria e të cilëve përmban aspekte në mospërputhje të plotë ose në kundërshtim me detyrimet ligjore dhe kuadrin rregullator.
  - Vlerësimi i riskut kryhet gjatë gjithë procesit të inspektimit, veçanërisht në fazat e planifikimit në nivel Strategjik dhe vjetor, por dhe gjatë procesit të inspektimit.
  - Vlerësimi i riskut është një procedurë sistematike dhe e vazhdueshme e DMKI në bashkëpunim me të gjitha drejtoritë e tjera në AKEP që ka për qëllim shqyrtimin, identifikimin, përcaktimin dhe kategorizimin e sektorëve, subjekteve dhe objekteve të inspektimit në bazë të riskut që ato prodhojnë ndaj interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

## ➤ QËLLIMET STRATEGJIKE DHE TEMATIKAT PËR VITIN 2024 – 2026

Një ndër qëllimet kryesore të inspektimeve të ushtruara nga DMKI është garantimi dhe zhvillimi i një konkurrence të ndershme në tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, si dhe vënien përpara përgjegjësi ligjore të atyre subjekteve që konstatohen në konflikt me ligjin.

DMKI, planifikon dhe bashkërendon veprimtarinë e inspektimit, siguron unifikimin e praktikave të mbikëqyrjes të tregut nëpërmjet inspektimit dhe monitorimit, duke vendosur theksin në cilësinë e shërbimit, të drejtat e përdoruesve dhe sigurinë në rrjet.

Objektivat kryesore dhe tematikat e inspektimit për vitet 2024 - 2026 do të fokusohen kryesisht (por pa u kufizuar) në verifikimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe detyrimeve ligjore të mëposhtme:

- *Zbatimi i Rregullores Nr. 37, Datë 29.10.2015 “Mbi masa teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.*

Verifikimi i detyrimit të sipërmarrësve që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, që të marrin masat e duhura gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura, në mënyrë që të garantojnë sigurinë, integritetin dhe funksionimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, si dhe të paraqesin pranë AKEP, çdo ndërhyrje, cenim ose incident në sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimit elektronik publik që ka një impakt të konsiderueshëm në funksionimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të tyre.

Rendësi e veçantë do të jepet planit të masave që sipërmarrësit aplikojnë për mbrojtjen e rrjeteve të komunikimeve publike ndaj aksesit të paautorizuar dhe mbrojtjen e përdoruesve dhe të dhënave vetjake dhe të privatësisë

Në këtë aspekt fokus i kushtohet gjendjes së teknologjisë, si dhe masave që duhen ndërmarr me qëllim sigurimin e një niveli të përshtatshëm sigurie për rrezikun e paraqitur.

- *Zbatimi i kushteve teknike të Rregullores Nr. 22 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërurbane të komunikimeve elektronike”.*

Verifikimi i përmbushjes së kërkesave teknike që duhet të përmbushen në zhvillimin, planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Infrastrukturës së Rrjeteve Kabllore Urbane dhe Infrastrukturës së Rrjeteve me Fibra Optike Nder-urbane të Komunikimeve Elektronike. Këto kushte janë një kornizë rregullatore për kushtet teknike që duhet të ofrojnë ndërtimi i infrastrukturës së rrjeteve kabllore apo i infrastrukturës së rrjeteve me fibër optike në fushën e komunikimeve elektronike.

Rrjetet kabllore dhe rrjetet me fibër optike janë pjesë thelbësore e infrastrukturës së komunikimeve elektronike, dhe i shërben zhvillimit, ndërtimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së tij në interes të Republikës së Shqipërisë.

Detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të shërbimeve e faciliteteve shoqëruese.

Sfide e përbashkët AKEP / Sipërmarrës mbetet ndërtimi i rrjeteve sipas standardeve, në respektim të kuadrit ligjor dhe duke u përshtatur me gjeneratën e re.

- Zbatimi Rregullores Nr.43 Datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”.

Verifikimi i garantimit dhe zbatimit të rregullt të procesit të portabilitetit të numrit nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike dhe ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, në përputhje me zgjidhjet teknike, mënyrën dhe afatet e përcaktuara në këtë rregullore duke vlerësuar në vijimësi këtë proces si një e drejtë themelore e pajtimtarit e sanksionuar në ligj.

Gjithashtu DMKI në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të AKEP do të vijojë monitorimin e të dhënave statistikore të gjeneruara nga sistemi CRDB mbi performancën e operatoreve në lidhje me zbatimin e afateve dhe rregullave të portimit.

- Zbatimi i Rregullores Nr.16 datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”, për mbulimin me shërbime broadband dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar.

Verifikimi i zbatimit të detyrimeve që sipërmarrësit kanë për treguesit e cilësisë së shërbimit për aksesin në rrjetin e qëndrueshëm (fiks) të komunikimeve publike dhe shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, aksesin në rrjetin e lëvizshëm të komunikimeve publike, dhe aksesin në Internet, pavarësisht teknologjive të përdorura.

Ndjekja e politikave për të ndihmuar në zhvillimin e rrjeteve me brez të gjerë të besueshëm dhe me shpejtësi të lartë, në maksimizimin e këtyre zonave për pjesën më të madhe të popullsisë, duke përfshirë zonat rurale dhe të thella, ku aksesin është shumë i vështirë.

Nxitja e një mjedisi që do të rrite investimet në rrjetet dhe shërbimet me brez të gjerë nga ofruesit ekzistues, duke inkurajuar dhe futjen në treg për sipërmarrës të rinj.

- Zbatimi i kushteve të përcaktuara në Rregulloren Nr.49, datë 11.03.2021 për “Mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

Respektimi i të drejtave dhe detyrimet të palëve për shërbimet që ofrohen, marrëdhënie e cila rregullohet nëpërmjet kontratës Sipërmarrës – Përdorues.

Në qendër dhe fokus të punës do të mbetet zgjidhja e problematikave që lidhen me të drejtat e konsumatorit (familjar apo biznes) duke i garantuar atyre akses në internet me cilësi të lartë, të përballueshëm, dhe mbi të gjitha siguri në shërbimet dhe aplikacionet e komunikimit që tashmë mbështesin nevojat sociale dhe ekonomike të tyre.

Verifikimi i zbatimit të kushteve të përcaktuara në këtë akt nënligjorë, synon të sigurojë një mbrojtje më efektive të konsumatorit apo pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike nëpërmjet parashikimit të rregullave më të qarta për të drejtat e pajtimtarëve në marrëdhëniet me operatorët, të cilat përfshijnë:



- kushtet për transparencën dhe publikimin e informacionit nga ofruesit e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike publike;
- rregulla të qarta për aksesin në shërbimet e emergjencës;
- detyrime të qarta për termat dhe kushtet të cilat duhet të përfshihen dhe të jenë pjesë përbërëse në kontratat e pajtimit për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike;
- saktësime për kohëzgjatjen, rinovimin dhe përfundimin e kontratave;
- rregulla për sistemin e faturimit dhe saktësinë e tij;
- masa për garantimin e aksesit të barabartë për personat me aftësi të kufizuara;
- rregulla më të qarta për trajtimin e ankesave nga operatorët dhe mbajtjen e rekordeve të tyre si dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pajtimtar-operator.

Gjithashtu do të ndiqet me prioritet zbatimi efektiv dhe qasjet e reja për të mbrojtur konsumatorët nga komunikimet e padëshiruara, mashtrimet, çështjet e privatësisë së të dhënave personale dhe tendencat e tjera që prekin konsumatorët. Strukturat inspektuese do ti japin rendësi të shtuar masave për të rritur konkurrencën dhe do të ndjekin politika që mbrojnë konkurrencën në treg, për të përmirësuar dhe mundësuar zgjedhjen e konsumatorëve dhe aksesin në informacion.

#### ➤ Respektimi i rasteve të kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme

Në zbatim të nenit 15 të Ligjit 9918/2008 i ndryshuar, AKEP pasi administron kërkesat nga organet ligj zbatuese me objekt bllokimin e faqeve web / domaineve me përmbajtje të paligjshme, njofton me shkresë zyrtare por edhe përmes postës elektronike, sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të kryer veprimet teknike të mbylljes së aksesit të faqeve elektronike të identifikuara nga këto organe, me përmbajtje të paligjshme.

Verifikimi i mbylljes së aksesit të faqeve web/domaineve me përmbajtje të paligjshme, do të jetë objekt i çdo inspektimi apo kontrolli, që inspektorët e AKEP do të kryejnë në subjektet e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

#### ➤ Bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) lidhur me fenomenin e piraterisë online

Një nga detyrat e vendosura nga Kuvendi i Shqipërisë (nëpërmjet rezolutës së miratuar), është marrja e masave nga AKEP lidhur me fenomenin e piraterisë audiovizive nëpërmjet internetit (online).

Ligji 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ka përcaktuar AMA-n si institucionin që Licencon çdo veprimtari audiovizive në Shqipëri. Është kompetencë e AMA-s verifikimi, konstatimi dhe ndalimi i çdo lloj transmetimi audiovizual që ofrohet pa

Licencim nga AMA, qoftë në format klasike të transmetimit me kablo, apo frekuenca, por edhe në formën e transmetimit online nëpërmjet internetit.

Ligji nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka si qëllim që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky ligj nuk zbatohet për përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike. Pra, AKEP nuk ka kompetencë funksionale të shqyrtojë dhe ndërhyjë në përmbajtjen e ofruar nga rrjetet e komunikimeve elektronike.

Në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit, nënshkruar në muajin nëntor të vitit 2021, mes AMA dhe AKEP, njësoj si në vitet e 2021-2023, edhe gjatë viteve 2024-2026, do të vijohet të operohet me Task-Force të përbashkët mes dy institucioneve, në subjekte ofrues të shërbimit të internetit, me qëllim për verimin dhe kontrollin e mbylljes së aksesit të faqeve web/domaineve që transmetojnë pirateri televizive online pa Licencë nga AMA.

➤ Zbatimi i detyrimit për ruajtjen e skedarëve e të dhënave të pajtimtar

Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike në bazë të nenit 101 të ligjit 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ruan dhe administrojnë për një afat 2-vjeçar, skedarët e të dhënave të pajtimtarëve në mënyre të sekretuar sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në kushtet kur ligji 9918/2008 nuk zbatohet për përmbajtjen e shërbimeve të ofruara nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike, këta skedarë nuk vendosen në dispozicion të grupit të inspektimit të AKEP. Gjithsesi përfaqësuesit e sipërmarrësve deklarojnë se në bazë të pikës 6 të nenit 101 të ligjit 9918/2008, skedarët e të dhënave të pajtimtarëve në mënyre të sekretuar do ti vihen në dispozicion pa vonesë, edhe në formë elektronike, autoriteteve që përcakton Kodi i Procedurës Penale, në bazë të kërkesës së tyre.

➤ Garancia dhe plotësimi i mekanizmave teknik me qëllim realizimin e përgjimeve të komunikimeve elektronike vetëm nga autoritetet e ngarkuara me ligj.

Në bazë të legjislacionit në fuqi sipërmarrësit e komunikimeve elektronike janë të detyruar të lejojnë autoriteteve publike dhe të ngarkuara me ligj pa asnjë kufizim dhe pa asnjë pagesë për përdorimin e rrjetit dhe shërbimeve të cilat ofroj, për të paralajmëruar publikun për kërcënimet e pashmangshme nga katastrofat e mëdha dhe për zbutjen e pasojave nga katastrofat e mëdha. Gjithashtu vetëm autoritetet e ngarkuara me ligj garantohen për përgjimin e informacionit të komunikimeve elektronike.

Neni 130 i ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se: *Përgjimi i ligjshëm i komunikimeve elektronike bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të përmbushin detyrimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

Kreu IV, neni 21 i Ligji Nr.9157, date 4.12.2003 “Për përgjimin e telekomunikimeve”, përcakton se:

1. Operatoret e telekomunikacioneve realizojnë me shpenzimet e tyre infrastrukturën e nevojshme ne rrjetin e tyre te telekomunikacioneve, për te siguruar aftësinë përgjuese ndaj përdoruesve qe shfrytëzojnë shërbimet e telekomunikacioneve te ofruara prej tyre.
2. Infrastruktura qe realizohet nga operatoret e telekomunikacioneve për te siguruar aftësinë përgjuese duhet te jete ne përputhje teknologjike me pajisjet e bërthamës komanduese elektronike dhe Sektorit te Përgjimeve ne SHISH.
3. Operatoret e telekomunikacioneve janë te detyruar te ofrojnë pa pagese çdo shërbim ne funksion te procesit te përgjimit.
4. Kur operatoret e telekomunikacioneve bëjnë përmirësimin e teknologjive, detyrohen te mbulojnë me shpenzimet e veta vazhdueshmërinë e funksionimit te procesit te përgjimit.

➤ *Zbatimi i Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 “Për Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.*

Verifikimi i zbatimit nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike, i detyrimit për deklarimin dhe publikimin në sistemin Atlas të AKEP të rrjeteve të tyre sipas teknologjive të përdorura në përputhje me afatet e përcaktuara në këtë rregullore;

AKEP ka ngritur dhe administron sistemin e “Sistemit të përqendruar të informacionit të rrjeteve të komunikimeve elektronike (Atlas)”, ku të gjithë sipërmarrësit e komunikimeve elektronike regjistrojnë rrjetin e tyre, në zbatim të Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 për “Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr. 120/2016 “Për Zhvillimin e Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë dhe Sigurimin e së Drejtës së Kalimit” si edhe Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 për “Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Sipërmarrësit të cilët ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar që rrjetin e tyre ta regjistrojnë dhe përditësojnë në ATLAS.

Për sa më lart, mbetet detyrë funksionale e strukturave inspektuese, verifikimi mbi zbatimin nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike, të detyrimit për deklarimin dhe publikimin në

sistemin Atlas të rrjeteve të tyre sipas teknologjive të përdorura në përputhje me afatet e përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi.

- Zbatimi i Rregullores Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al” si dhe verifikimin e regjistrimit të një domain-i nën zonën “.al” sipas procedurës përkatëse.

Domain-i është tërësia e një serie karakteresh alfanumerike që përfshin shkronjat nga A deri tek Z, numrat nga 0 deri tek 9 dhe shenjën minus “-”, është emër që mund të përdoret për të përcaktuar praninë unike në Internet.

Regjistrimi i një domain-i nën zonën “.al” kryhet nëpërmjet AKEP dhe Regjistruarve të Autorizuar nga AKEP për të bërë regjistrimin e domaineve nën “.al” në përputhje me Rregulloren Nr. 2 datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domain-eve nën “.al”.

Aplikuesi përpara se të regjistroj një emër domain në zonën “.al” duhet të sigurohet nëse domain-i që dëshiron të regjistroj nuk është pjesë në Listën e emrave të Ndalar, Listën e emrave të Rezervuar të përcaktuar në Rregulloren Nr. 2, datë 21.02.2008, si dhe të kryej kërkim në faqen web të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Intelektuale (DPPI) në mënyrë që emri i domain-i të mos jetë markë/patente e regjistruar nga kjo drejtori.

Për sa më lart, mbetet në fokus të punës së strukturave inspektuese;

- Verifikimi i kushteve, procedurës dhe rregullave për administrimin e procesit të regjistrimit dhe administrimit teknik për qeverisjen e zonës së emrave të domain-eve (emra domain-esh nën .al dhe nën “.gov.al, mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al, .net.al”);
- Verifikimi emrave të domain-eve të regjistruar krahasuar me listën me emra të rezervuar të domaineve .al dhe nëndomaineve.

## ➤ INSPEKTIMI NË FUNKSION TË RRJETEVE TË SIGURTA

Me qëllim funksionimin e rrjeteve të sigurta dhe të pastra (clean networks), strukturat inspektuese gjatë procedurave inspektuese do të verifikojnë tek sipërmarrësit që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm masat e ndërmarra gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura, në mënyrë që të garantojnë sigurinë, integritetin dhe mirë funksionimin e tyre.

Gjithashtu nëpërmjet inspektimit do të realizohet monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të detyrimeve që sipërmarrësit kanë për treguesit e cilësisë së shërbimit, për aksesin në rrjetin e

qëndrueshëm (fiks) të komunikimeve publike dhe shërbimit telefonik të disponueshëm për publikun, aksesin në rrjetin e lëvizshëm të komunikimeve publike, dhe aksesin në Internet.

Inspektimi do të sigurojë që ofruesi i shërbimit të komunikimeve elektronike publike ndërmerr masa adekuate teknike dhe organizative për ta mbrojtur sigurinë e shërbimeve.

Strukturat inspektuese të AKEP (dhe jo vetëm), do të marrin masat e duhura për të zbutur rreziqet e sigurisë së rrjetit nga furnitorët dhe ofruesit e pajisjeve të rrjetit, të cilët konsiderohen si një rrezik për të gjithë furnizuesit dhe ofruesit e pajisjeve të rrjetit 5G, ose të gjeneratës së re.

Për të arritur këtë qëllim do të bëhet periodikisht një vlerësim i rrezikut për furnizuesit e rrjeteve të gjeneratës së tjetër, dhe ofruesve të tjerë të pajisjeve të rrjetit të gjeneratës së re.

Gjithashtu në këtë aspekt rëndësi do të kushtohet edhe mbrojtjes e sigurisë kibernetike, nëse furnizuesit dhe ofruesit përfaqësojnë një rrezik për sigurinë kombëtare. Për arritjen e këtij qëllimi do të vlerësohet profili i rrezikut në nivel kombëtar për të gjithë furnizuesit duke garantuar një rrjet dhe ndërveprim të sigurtë dhe të besueshëm.

#### ➤ PRITSHMËRITË E SEKTORIT PËR NJË TREG TË QËNDRUESHËM.

Për të pasur një treg të qëndrueshëm në sektorin e komunikimeve, strukturat inspektuese të AKEP do japin kontributin e tyre duke qenë më proaktiv, dhe duke u fokusuar në disa fusha, si:

- Kontrolli periodik dhe rastësor të sipërmarrësve, për të siguruar respektimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi;
- Parandalimi dhe shmangia e informalitetit;
- Sigurimi për mos krijimin e barrierave për ISP-ve të reja që synojnë të hyjnë në treg;
- Organizim i takimeve me përfaqësues të sipërmarrësve, aktorëve dhe faktorëve të tjerë institucional, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave, apo shqyrtimet e ankesave.

DMKI ka përgatitur këtë Plan Strategjik të Inspektimit i cili bën të mundur mbulimin e risqeve kryesore për fushat e inspektimit për një periudhë tre vjeçare 2024-2026. Si pjesë e procesit të përgatitjes së planit strategjik, inspektimi i përmbahet disa dokumenteve kyçe, ku përfshihen raportet mujore, vjetore të inspektimit e të tjera materiale të jashtme të cilat ndihmojnë që të krijojnë një panoramë mbi gjendjen e sipërmarrësve të inspektimit, si dhe risqet që i duhet të përballojë për të kryer një planifikim sa më efektiv.

Puna e strukturës inspektuese përmes transparencës dhe profesionalizmit sipas standardeve dhe kërkesave të përdoruesit, vetë subjekteve dhe mbi të gjitha të Kuvendit të R.Sh. do të bëjë të mundur dhënien e kontributit të duhur brenda institucionit si dhe do të japë impaktin potencial edhe jashtë AKEP.

Në fillim të kësaj dekade, do të ishte e vështirë të parashikohet shkalla e transformimit në sektorin e komunikimeve si dhe të ndikimi që sfidat globale - të tilla si Pandemia e Covid-19 dhe lufta në Ukrainë - do të kishin në sektorin e komunikimeve elektronike.

Në mënyrë të ngjashme, duke parë nga e ardhmja, është e pamundur parashikojnë të gjitha ato teknologjike dhe risitë sociale që do të formësojnë mënyrën se si do jetojmë dhe punojmë.

Gjithsesi nëpërmjet kësaj strategjie, kemi miratuar një vizion për sektorin e inspektimeve të sipërmarrësve që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e komunikimeve komunikimeve ku në qendër janë fokusuar të drejtat e konsumatorit (familjar apo biznes) duke i garantuar atyre akses në internet me cilësi të lartë, të përballeshëm, dhe mbi të gjitha siguri në shërbimet dhe aplikacionet e komunikimit që tashmë mbështesin nevojat sociale dhe ekonomike të tyre.

Nga ana tjetër edhe ndaj sipërmarrësve të komunikimeve elektronike kemi nxitur frymën e bashkëpunimit duke garantuar zhvillimin e një konkurrencë të ndershme në tregun e komunikimeve elektronike dhe marrjen e masave si instrument për të luftuar informalitetin dhe abuzimet me ligjin.